

A KE TI TË DREJTA MË SHUMË SE UNË?

*Jo,
në demokraci të
gjithë i kemi të drejtat
e barabarta, pa asnjë
dallim*



THESARI MË I ÇMUAR I JETËS SONË

ESMA (13), BLEND (13), ARIS (13), ARGJEND (13), LEOTRIM (13), FJOLLA (13), ENESA (13)



Nga Greqia e lashtë na erdhi një thesar i çmuar. Se çfarë fshihej brenda tij, do ta mësoni në artikullin tonë

Në vitin 507 p.e.s. ndodhi një mrekulli që përmirësoi jetën e shumë njerëzve në planetin Tokë. Kjo mrekulli erdhi nga Athina, kryeqyteti i Greqisë.



Të rrethuar me vlera demokratike

Falë saj, shumë shtete përjetuan zhvillim dhe tani përgëzojnë të drejtat e tyre të patjetërsueshme. Kjo mrekulli njihet si demokraci. E vetë demokracia është sistem i vlerave të mëdha. Ne e quajmë si thesar të çmuar, për arsye se brenda këtij thesari ka copëza diamanti që e bëjnë të shkëlqej edhe më shumë. Shkëlqimin thesarit tonë të çmuar, ia shtuan vlerat përbërëse të tij të cilat janë: respekti, toleranca, barazia, liria, solidariteti, etj. Këto vlera të çmuara të demokracisë i zbatojmë shumë

në klasën tonë dhe në ambientin ku jetojmë. Ne shumë herë jemi treguar solidarë, sepse kemi bërë mbledhjen e parave për persona me nevoja të veçanta të cilët kishin nevojë për përkrahjen tonë. Po ashtu, ne në klasë kemi pasur rastin që të votojmë duke zgjedhur kështu kryesinë e klasës. Këtë e kemi bërë me votat tona të lira. E kjo po që quhet demokraci. Deri më tash ne nuk e dinim edhe aq vlerën e sistemit në bazë të të cilit jetojmë, por tani e dimë se çka është kuptimi i fjalës demokraci dhe e dimë vlerën që ka ajo në jetën tonë. Pra, qytetarë të dashur, të bëhemi të gjithë aktiv dhe ta ruajmë thesarin tonë të çmuar, demokracinë. Jo të gjithë e kanë fatin ta kenë këtë sistem. Prandaj, të provojmë të jemi edhe më shumë të përkushtuar për vendin tonë, sepse kështu e ndërtojmë më tutje shtetin tonë demokratik.



Grupi i deputetëve të ardhshëm

MËNYRA SE SI NE UDHËHEQIM

SAMIR (13), GENTRIT (13), RRAHIM (13), ESMA (13), VENERA (13), ERIONITA (13), DONJETA (14)

Ne jemi nxënës të klasës VIII-3 nga shkolla „Hilmi Rakovica“ dhe ne do t’iu tregojmë për dy personazhe shumë të dashura për ne. Nëse dëshironi t’i takoni edhe ju ata, lexoni më poshtë

Përsëritet për të gjithë juve, lexues të dashur. Ne e njohim një vajzë. Ajo quhet Esma. Esma është e ri-tur dhe ka mbi 18 vjet. Ajo punon në një organizatë bamirësie. Esma, ky personazh kaq i dashur, kishte një ëndërr të kahmotshme. Ajo dëshironte të hapte disa spitale, ku të gjithë qytetarët do të mund të shkonin të shëroheshin aty pa pagesë. Një ditë në një park Esma takoi disa njerëz. Ajo filloi të bisedonte me ta duke iu treguar atyre për ëndrrën e saj të veçantë. Duke biseduar, ajo pa se edhe qytetarët e tjerë kishin mendim të njëjtë. Kështu, Esma me të tjerët vendosën të formonin një parti politike, e cila quhej „Partia e të gjithëve“. Pas disa muajve, zgjedhjet ishin afuar dhe anëtarët e partisë më të re në Kosovë, kandiduan për deputetë. Këto ishin zgjedhjet parlamentare apo


ndryshe zgjedhjet qendrore. Ato organizoheshin në tërë Kosovën dhe të gjithë kandidatët shpresonin që të fitonin sa më shumë ulëse në Kuvendin e Kosovës. Partia e Esmës fitoi shumë vota, sepse u pëlqye nga qytetarët. Tashmë Esma nuk është një qytetare e thjeshtë, por është një deputete. Si e tillë, ajo ka të drejtë të propozoj projektligje dhe në ditët e para të punës, ajo mendoi për ëndrrën e saj. Fatmirësisht, projektligji i saj mori shumë më shumë se 61 vota nga deputetët e tjerë dhe u kthye në një ligj të vërtetë. Por, çka do të thotë kjo? Kjo do të thotë se në Kosovë do të ndërtoheshin shumë spitale pa pagesë, falë punës së Esmës. Ëndërra e saj më në fund u realizua dhe ne jemi të gjithë shumë të lumtur për të. Qytetarët janë ata të cilët mund të sjellin gjëra të mira, ngado!




Ky është njëri nga kandidatët nga Partia e Esmës



Grupi që punoi për zgjedhjet



Qytetarët mund të bëjnë zgjedhje të ndryshme



Voto për „Partinë e të gjithëve“

DETYRAT E DY INSTITUCIONEVE TË KOSOVËS


RAMADAN (13), ERITA (13), ENIS (13), AMIRA (14), VESEL (13), OLSA (13), RIAD (13), ENDRIT (14)

Shkollimi
ynë është shumë
i rëndësishëm për shtetin
tonë. Prandaj, Ministria e Arsimit
kujdeset që të gjithë ne të jemi pjesë
e procesit të arsimit.
Ne jemi shumë të lumtur që
jetojmë në një shtet siç është
Kosova



Institucionet të cilat e rregullojnë mënyrën e të jetuarit të qytetarëve në Kosovë janë Kuvendi dhe Qeveria

Kuvendi i Kosovës është institucion i cili ndryshe quhet „Shtëpia e Popullit“. Aty ushtrojnë postin 120 persona të quajtur deputetë. Disa funksione që kryen Kuvendi i Kosovës janë: përfaqësimi i qytetarëve, prej të cilëve edhe janë zgjedhur deputetët, funksioni i miratimit



apo mos miratimit të ligjeve, varësisht nga rëndësia që e ka ai projektligj, si dhe monitorimi i punës të cilën e bën Qeveria.

Kur jemi tek Qeveria, kemi çka të flasim mjaftueshëm edhe për këtë institucion. Ajo është nën udhëheqjen e Kryeministrit. Pastaj ka edhe punonjës të tjerë të cilët i kanë punët e ndara, p.sh. Ministri i Arsimit merret me çështjet e arsimit. Kjo Ministri ka një ndikim të madh në jetën tonë si nxënës, sepse i gjithë procesi i mësi-

mit mundësohet nga kjo Ministri.

Kemi shembuj të ndryshëm ku mund ta lidhim jetën tonë të përditshme me punën të cilën e bëjnë ministrat. Çka ne do të donim që Ministria e Arsimit në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të bënte për nxënësit e të gjitha shkollave të Kosovës është që të sigurojnë mjete për ekskursione të ndryshme, vizita në muzeume, ekspozita, etj. Kjo do të na ndihmonte edhe më shumë ta njohim vendin tonë, në aspektin historik, gjeografik, kulturor, etj. Pastaj, nga Ministria e Shëndetësisë do të donim të na ofrojnë kartela të veçanta për kontrolla mjekësore. Sot e kuptuam sa i rëndësishëm është bashkëpunimi i Qeverisë me Kuvendin, sepse me miratimin dhe me zbatimin e ligjeve, jeta jonë do të përmirësohet dhe e ardhmja jonë do të jetë edhe më e ndritur. Ne ju falenderojmë që ju gjetët kohë të lexoni artikullin tonë.



Ne, e tashmja dhe e ardhmja e shtetit të Kosovës

DEMOKRACIA PRESIDENCIALE

RILIND (13), RINESA (13), ALTIN (13), ARIZON (13), ALBINOT (13), ALBIN (13), ILIRJANA (13), EGZONA (13)



Një ndër çështjet më me rëndësi për demokracinë është mënyra e zgjedhjes së përfaqësuesve të shtetit

Ka shumë vende në botë që kanë udhëheqje të ndryshme nga njëra-tjetra. Është Kushtetuta ajo që e parashihet mënyrën e funksionimit të shtetit. Kosova si shtet demokratik ka sistem parlamentar të qeverisjes, që nënkupton se në Kosovë shteti udhëhiqet nga Kuvendi. Ky institucion, luan rol shumë të rëndësishëm në jetën e secilit qytetar.

Por, përveç këtij sistemi, ekziston edhe sistemi presidencial. Në këtë sistem, Presidenti zgjedhet direkt nga ana e popullit dhe të gjitha ligjet miratohen nga Presidenti. Gjë që është e kundërta e asaj se qysh funksionon vendi ynë.

Presidenti ka shumë përgjegjësi në të dy sistemet, por roli tij është dukshëm më i madh në sistemin presidencial. Për shembull, në sistemin parlamentar (sistem të cilin e ka Kosova) detyrat e Presidentit janë: përfaqësimi i popullit në arenën ndërkombëtare, shpallja e ligjeve të miratuara nga Kuvendi, propozimi i projektligjeve, propozimi i amendamentimit të ligjeve që janë miratuar në Kuvend, etj. Me fjalën amendamentim kuptojmë propozimin për ndryshim të ndonjë neni brenda një ligji të caktuar. Pra, këtë të drejtë e gëzon Presidenti në sistemin parlamentar.

Kurse, në sistemin presidencial, përpos këtyre që i cekëm më lart, Presidenti është njëkohësisht kryetar i

Qeverisë, kryetar i shtetit dhe kjo nënkupton se i gjithë pushteti i shtetit rrjedh nga vetë Presidenti. Por, ky është fenomen vetëm për vendet demokratike, sepse qytetarët përmes votës i zgjedhin qoftë deputetët, qoftë Presidentin.

Cili prej këtyre dy sistemeve mund t'i plotësojë më mirë kërkesat e një demokracie kushtetuese: sistemi parlamentar apo ai presidencial? Sipas nesh, të dy sistemet janë të mira si ai presidencial ashtu edhe ai parlamentar. Shembulli më i mirë i sistemit presidencial janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e ne të gjithë e dimë sesa demokratike janë ato.

Por, edhe ne me sistemin parlamentar funksionojmë shumë mirë. Që të dy sistemet punojnë për të mirën e qytetarëve. Andaj, për ne nuk ka rol të madh në cilin sistem jemi. Për ne, ajo çka ka rol shumë të rëndësishëm është pjesëmarrja aktive dhe angazhimi i qytetarëve në vendin e tyre.



E ardhmja e vendit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Hitmi Rakovica“
Klasa: VIII-3
Vendi: Prishtinë